



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/271  
Datë: 10.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete buxhetore për mbështetje të Këshillit Kombëtar Shqiptar, sipas Memorandumit të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Kombëtar Shqiptar, në vlerë prej 304,511.16€ (treqindekatër mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë euro e gjashtëmbëdhjetë centë) për pajisjen me 35,448 tekste shkollore për 3,650 nxënës shqiptarë të shkollave fillore, të komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje, si dhe për avokimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes së Luginës së Preshevës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe organizatat ndërkombëtare përkatëse.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përdoren mjetet nga organizata buxhetore Zyra e Kryeministrit, me kod 104, nënprogrami "Përkrahje për Luginën e Preshevës", me kod 39100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi do të transferohen në llogarinë bankare, në emër të Këshillit Kombëtar Shqiptar HALKBANK Iban: RS 35155007040000131481.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

*PËR*  
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/271

Datë: 10.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet).
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

*PËR*

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Aneks A (Kursimet)

| BLOKU KODUES                         | ORGANIZATA               | PROGRAMI                    | KAT   | KATEGORIA                                   | Shuma        |
|--------------------------------------|--------------------------|-----------------------------|-------|---------------------------------------------|--------------|
| 10/206/130650/4123/0721              | MINISTRIA E SHENDETESISE | ADMINISTRATA QENDRORE - MSH | 14123 | FAZA E I- RE E NDERTIMIT TE QEND. EMERGJENT | 1.000.000.00 |
| Total -Kursime ne Investime Kapitale |                          |                             |       |                                             | 1.000.000.00 |
| TOTAL KURSIME                        |                          |                             |       |                                             |              |



Aneksi B (Ndarjet)

| BILOKU_KODUES              | ORGANIZATA                 | PROGRAMI                   | KAT | KATEGORIA | SHUMA        |
|----------------------------|----------------------------|----------------------------|-----|-----------|--------------|
| 10/232/13100/38/00000/0112 | SHPENZIMET E PAPAASHIKUARA | SHPENZIMET E PAPAASHIKUARA | 38  | REZERVA   | 1.000.000.00 |
| Total -Ndarje              |                            |                            |     |           | 1.000.000.00 |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/271  
Datë: 10.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë eurosh), për familjen e Zyrtarit Policor të rënë në krye të detyrës, gjatë sulmit terrorist në Banjskë, Heroit Afrim Bunjaku, për ndërtimin e një hapësire pritjeje e cila do të shërbejë për të gjithë qytetarët, në shenjë respekti dhe nderimi për jetën dhe veprën e tij.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga "Shpenzimet e Paparashikuara", me kod 232, nënprogrami "Shpenzimet e Paparashikuara", me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Thesari që të realizojë transferin e mjeteve sipas pikës 1. të këtij Vendimi, në llogarinë bankare të caktuar nga familjarët e Heroit Afrim Bunjaku, të siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

*PËR*  
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/271  
Datë: 10.10.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 200,000.00€ (dyqind mijë eurosh), për renovimin e objektit në Mitrovicën Veriore, që do të shfrytëzohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht Administrata Tatimore e Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga "Shpenzimet e Paparashikuara", me kod 232, nënprogrami "Shpenzimet e Paparashikuara", me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me kod 214, në nënprogramin "Departamenti i Standardeve dhe Politikave të IMNQ", me kod 12300, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale" në projektin "Renovimi i Objekteve Qeveritare", me kod 12992.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

*për*  
Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë